



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 235, Datë 22.09.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SMART TRADE & CONSULTING”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 173, DATË 26.10.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr.1539/3 prot., datë 19.09.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Bazuar në kërkesën dhe aplikimin e shoqërisë, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 215, datë 24.08.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “SMART Trade and Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin nr. 215/2022, në datat 25.08.2022 dhe 26.08.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 08.09.2022), nuk ka rezultuar që të ketë të tilla. Gjithashtu, me shkresën nr. 1384/2 prot., datë 25.08.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/3 prot., datë 07.09.2022, shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të sa depozituar, rezulton se mbetet ende informacion/dokumentacion për t’u depozituar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1384/4, datë 15.09.2022. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/5 prot., datë 19.09.2022 shoqëria ka plotësuar dhe pjesën e mbetur të dokumentacionit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 389, seria T17, të shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 27.10.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI